

VENDIM
Nr. 92, datë 6.9.2013

PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HEC “KOKA 1”, TË SHOQËRISË “SNOW ENERGY” SHPK SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9 pikat 1 dhe 2 germa “a”, të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Snow Energy” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec “Koka 1”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7, pika 3, germat “a”, “b”, “c”

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Snow Energy” sh.p.k. për kualifikim të impiantit prodhues për hec “Koka 1”, si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË
Shkëlqim Bozgo